



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

FTESË PËR SHPREHJE INTERESI

Për recensentë për vlerësimin e dorëshkrimeve, për tekstet e reja shkollore dhe materialet mësimore për klasat 4 dhe 9 të pranura në MASHTI në bazë të konkursit të shpallur më datë 04 nëntor 2020.

Përshkrimi i përgjithshëm i angazhimit:

Recensentët do të jenë përgjegjës për vlerësim kritik dhe profesional të dorëshkrimeve dhe materialeve mësimore.

Kriteret e përzgjedhjes për recensentë:

- Përzgjedhja e recensentëve dhe përcaktimi i ekipeve për fusha/lëndë të ndryshme do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara me Ligjin Nr. 02/L-67 dhe UA Nr. 18/2018.
- Recensentët duhet të kenë kompetencë profesionale për vlerësimin e dorëshkrimeve.
- Recensentët kërkohet të jenë:
 - (1) Mësimdhënës universitar/punonjës shkencor i lëndës përkatëse me gradën më të lartë shkencore;
 - (2) Bashkëpunëtor shkencor me gradën më të lartë shkencore;
 - (3) Studiues me gradën më të lartë shkencore;
 - (4) Mësimdhënës i licencuar;
 - (5) Pedagog shkollor;
 - (6) Psikolog shkollor;
 - (7) Gjuhëtar.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Letërnjoftim i vlefshëm i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës;
- Curriculum Vitae (CV);
- Formulari i Aplikimit;
- Dëshmi të kualifikimit;
- Dokumente të tjera që dëshmojnë punën ne recensione;

Shpjegime shtesë:

- Afati për dorëzim të aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e publikimit 28/ 12/ 2021
- Aplikimet e pranuar pas përfundimit të afatit nuk do të merren parasysh.
- Aplikacionet dorëzohen në kopje fizike në zarf të mbyllur në zyrën numër 4, në MASHTI.
- Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të informohen për rezultatin e aplikimit të tyre në kohën e duhur.
- Aplikimet që nuk janë në përputhje kërkesat thelbësore të specifikuara në këtë Konkurs nuk do të merren parasysh.